

Interviste për gazetën “Tirana Observer” lidhur me përplasjet e fundit ne Komunitetin Mysliman Shqiptar

Xhavit Shala

Ekspert për çështje të sigurisë kombëtare

Tiranë 19.3.2009

Tirana Observer: Ditët e fundit ka nisur një debat për zgjedhjet e reja për kreun e Komunitetit Mysliman Shqiptar. Sipas jush a është i papritur ky debat, apo është një diçka që ishte e përgatitur që më parë.

Xhavit Shala: Sensibilizimi i opinionit për zhvillimet në komunitetin mysliman shqiptar nuk është i tepruar. Çështjet fetare në Shqipëri janë mjaft të rëndësishme për sigurinë tonë kombëtare. Në këtë kontekst zhvillimet në një komunitet fetar nuk janë çështje thjesht e atij komuniteti por janë çështje e të gjithë shqiptarëve. Aq më tepër kur bëhet fjale për Komunitetin Mysliman, besimit të cilit i përket pjesa më e madhe e popullsisë shqiptare.

Për mua zhvillimet e fundit në Komunitetin Mysliman nuk janë të papritura. Ka mbi dhjetë vjet që përfaqësues të rrymave radikale kanë bërë përpjekje dhe kanë dështuar në tentativën e tyre për të marrë nën kontroll strukturat zyrtare të Komunitetit Mysliman në Shqipëri. Këto janë rryma radikale në Islam, si vehabi-selefizmi, të cilat janë të huaja jo vetëm për islamin tradicional shqiptar, por janë të papranueshme edhe nga shume vende islamike, bile dhe nga vendet arabe. Këto rryma kanë hyrë në Shqipëri menjëherë pas përmbyesjes së komunizmit, nëpërmjet disa OJQ-ve nga vendet e Gjirit Persik, sidomos nga Arabia Saudite, ku këto rryma janë në pushtet.

Tirana Observer: Po përse kanë strategji këto vende dhe cili është qëllim i tyre?

Xhavit Shala: Depërtimi në islamin ballkanik është një strategji e përpjekje e kahershme e vehabizmit. Pra synimi i tyre nuk ka qene thjesht në Shqipëri. Synimi i tyre është marrja e kontrollit të strukturave të Bashkësive Islame edhe në Bullgari, Bosnje, Sanxhak, Maqedoni e Kosovë.

Fatkeqësisht, edhe në Kosovë e Maqedoni, duke përfituar nga varfëria dhe papunësia e madhe, nëpërmjet OJQ-ve kanë depërtuar në përmasa të rrezikshme.

Sipas këtyre rrymave, myslimanët e Ballkanit e kanë deformuar fenë islame dhe ka kohë që janë larguar nga islami i vërtetë. Por, për rreth pesëqind vjet, feja islame në Ballkan mori disa karakteristika që e bënë atë më të moderuar e tolerante dhe të pranueshme nga evropianët. Ky zhvillim në besimin islam në Ballkan nuk e ka cenuar aspak karakterin universal të fesë islame.

Realisht feja islame ndër shqiptarët është e moderuar dhe ka luajtur një rol të jashtëzakonshëm në forcimin e tolerancës fetare të shqiptarëve. Pikërisht këtë duan të godasin vehabi-selefistët. Dukë tentuar të radikalizojnë besimin fetar islam ata do të tronditin themelet e tolerancës sonë fetare, duke u kthyer kështu në një kërcënim serioz për sigurinë tonë kombëtare.

Pra tentativa e tyre për të marrë kontrollin mbi strukturat drejtuese të Komunitetit Mysliman Shqiptar nuk është e re. Agjencitë ligjzbatuese shqiptare kanë qenë informuar në kohë për miliona dollarët e hedhur nëpërmjet OJQ-ve arabe për këtë problem.

Një pjesë e këtyre parave janë investuar për shkollimin në vendet arabe të personave që janë zgjedhur nga përfaqësuesit e këtyre rrymave ekstremiste, të cilët do të ishin mbështetësit dhe shpresa e tyre në të ardhmen. Mos të harrojmë se në krye të këtyre OJQ-ve që bënin përzgjedhje kanë qenë edhe element në kërkim ndërkombëtar për akte terroriste. Disa nga këta u arrestuan në vitet 1998-2000 nga agjencitë shqiptare të zbatimit të ligjit.

Tirana Observer: Sa shkon ky numër?

Xhavit Shala: Numri i tyre ka ndryshuar. Disa e kanë mbaruar, të tjerë janë regjistruar. Ka pasur momente kur studimet atje i ndiqnin rreth 300 studentë nga trojet shqiptare. Disa nga të përzgjedhurit e OJQ-ve arabe, janë diplomuar dhe janë pjesërisht ata që përfaqësojnë vehabi-selefizmin.

Tirana Observer :Ish-kreu i shërbimit sekret Fatos Klosi është shprehur se këto shkolla janë gjysmë ushtarake, si është e vërteta?

Xhavit Shala: Po. Ka pasur raporte për këtë problem. Këta persona janë të evidentuar nga strukturat përgjegjëse. Për mua shqetësim më të madh përbën fakti se një pjesë prej tyre janë shkolluar më një variant të islamit që është kundër traditës shqiptare dhe janë sponsorizuar për ta përhapur këtë variant.

Tirana Observer: Po si është bërë përplasja e tyre me këta që janë sot në drejtim të Komunitetit?

Xhavit Shala: Fushata zgjedhore në Komunitetin Mysliman po zhvillohet normalisht. Vetë statusi e ka të përcaktuar mënyrën se si do të zhvillohen

zgjedhjet. Kam vënë re se vetë Komuniteti Mysliman në këto vitet e fundit ka ndjekur politikën e përfshirjen në strukturat e tij, kuptohet në përshtatje dhe me statutin, edhe të atyre që jo rrallë pozicionoheshin si krahu radikal. Kjo mendoj ka qenë taktikë e mirë, por situata duhet ndjekur në dinamikë. Sepse mund të ketë qenë taktike edhe e tyre përfshirja në këto struktura, me qëllim që të “marrin kalanë” nga brenda. Mbase me këtë sy duhet parë riaktivizimi i disa prej tyre këto kohët e fundit.

Tirana Observer: Cila është realisht fuqia e atyre që mendohet si krahu radikal?

Xhavit Shala: Realisht pas ngjarjeve të 11 shtatori të vitit 2001, fuqi e tyre ka rënë ndjeshëm. Ka rënë sepse burimet financiare për ta u bllokuan si të dyshimta. Disa shtetas të huaj me aktivitete të dyshimtë, kryesisht arab, si dhe disa nga OJQ-të që figuronin në listën e OKB-së si financuese të terrorizmit u përzhunë nga Shqipëria. Por, pas kësaj, disa mbështetës të vehabi-selefizmit u gdhinë me aktivitete private dhe kaluan në vetëfinancim.

Tirana Observer: Po e ardhmja si mund të jetë e kësaj çështje?

Xhavit Shala: Mendoj se në Komunitetin Mysliman ka mjaft persona të përgjegjshëm e patriot, të cilët më shumë mbështesin myslimanizmin shqiptar se sa “internacionalizmin islamik”. Ata do të dinë t’u japin drejtim punëve.

Gjithashtu dhe shteti shqiptar e ka kuptuar se kur vjen puna për çështje fetare dhe impaktin që këto çështje kanë për sigurinë tonë kombëtare duhet hequr dorë nga pozicioni i “neutralitetit pasiv” për të kaluar në atë të “laicitetit aktiv”

Intervistoi Roland Qafoku

Botuar ne “Tirana Observer “ 19 mars 2009

TIRANA OBSERVER



Personazhet dhe personat te tet franceze teper j te njohura ne Shqipëri.

EMRAT FRANCEZË TË PERJETËSUAR NË TIRANË, RRUGËT DHE INSTITUCIONET

ISH-KRYEPOLICI XHAVIT SHALA

"300 të diplomuar në Gjirin Persik synojnë kreun e Komunitetit Mysliman"



BANKA E SHQIPERISE
GAFANE PRRERJEN 2 MUE LEKESHE

SONDAZHET, "ORANE WS" FRMOS ME "IPR. MARKETING"

10 POL. TIKANET ME TE PASUR NE DOTE, I PARINJE RUS

TE STI I ADN-SË, PAS 27 VJESH BURG DEL I PAFAJSHËM



INTERVISTA ISH-FUTDOLLISTI I KOMBE TARES
Skënder Gega:
Arrestimi i vëllait tim, Haliti

Përsëri debati Rama-Berisha



ALIN SHTANI

Festa e Tetillit



VLADIMIR LAME

ARMO HEDH PER HERE TE PARE NE TREG NAFTEN "ZURCO E ZEL"

SIGMA
VALIENNA INSURANCE GROUP
Sigurimet e jetës dhe të pasurisë tuaj. Sigurimet e shpirtit dhe të shpirtit tuaj. Sigurimet e shpirtit dhe të shpirtit tuaj.

NOBEL "Nobel Group"
English - German - Italian
Këtu është qendra e kompanisë së sigurimit "NOBEL" në Tiranë. Këtu është qendra e kompanisë së sigurimit "NOBEL" në Tiranë. Këtu është qendra e kompanisë së sigurimit "NOBEL" në Tiranë.

ALPET
ENERGJI POSITIVE